



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. Prot.

Vlorë, më 12.12.2016

Vendim
Nr. 79, datë 12.12.2016

PËR FUNKSIONIMIN E GRUPEVE MËSIMORE, GRUPEVE TË
PËRKOHSHME/TË PËRHERSHME KËRKIMORE-SHKENCORE DHE
STANDARDET E SHPËRNDARJES SË NGARKESËS MËSIMORE VJETORE
NË AUDITOR

Në mbështetje të pikës 5 të nenit 25 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", në zbatim të rekomandimeve të MAS për organigramën e fakulteteve dhe mungesën e grupeve mësimore e kërkimore (Raporti i Inspektimit nr 5265, prot, datë 01. 08. 2014, faqe 7), dhe në zbatim të Vendimit Nr. 32 të Senatit Akademik, datë 06. 09. 2016, "Për fillimin e procesit të riorganizimit akademik dhe administrativ të institucionit dhe hartimin e strukturës së përgjithshme të tij", Senati Akademik në mbledhjen e datës 12.12.2016

VENDOSI:

1. Grupet mësimore dhe grupet e përhershme/e përkohshme me karakter kërkimor-shkencor në UV janë ministruktura që kryejnë veprimtari akademike vetëm brenda departamentit, në funksion dhe në varësi të tij.
2. Grupet mësimore dhe grupet e përhershme/e përkohshme me karakter kërkimor-shkencor nuk janë njësi *përfaqësuese, të pavarura dhe të mëvetësishme*. Veprimtaria e tyre është gjithmonë në funksion të detyrave dhe misionit të departamentit, të parashikuara në ligjin e arsimit të lartë dhe akteve të tjera nënligjore.
3. Përgjegjësi i grupit mësimor dhe grupit të përhershëm/të përkohshëm me karakter kërkimor-shkencor *nuk është autoritet drejtues*. Ai kryen detyra akademike në funksion të përgjegjësit të njësisë bazë duke vepruar gjithmonë sipas udhëzimeve të tij.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

4. Përgjegjësi i grupit mësimor apo kërkimor-shkencor propozohet nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe emërohet nga dekan. Përzgjedhja e tij nga përgjegjësi i departamentit bëhet mbi bazë kriteresh, referuar titullit, gradës, performancës, kontributit shkencor, akademik dhe pedagogjik të personelit akademik, sipas procedurave të parashikuara në pikën C.1 të këtij vendimi. Në raste ankesash dhe mosmarrëveshesh të mundshme lidhur me respektimin e kriterëve dhe procedurave sugjerimi/vendimi i Rektorit është përfundimtar.

A. Për funksionimin dhe veprimtarinë e grupit mësimor.

1. Sipas përvojave dhe modeleve universitare, të huaja dhe shqiptare, një grup mësimor përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) anëtarë. Sipas realiteteve të njësisë bazë grupi mund të përbëhet nga 4 (katër), 5 (pesë) apo 6 (gjashtë) anëtarë.
2. Grupet mësimore mbulojnë veprimtarinë mësimore të një ose më shumë disiplinave të ngjashme dhe të ndërvarura të formimit të përgjithshëm dhe atij profesional/karakterizues.
3. Grupet mund të kryejnë edhe aktivitet e shërbime për të tretët, në funksion dhe në emër të departamentit, duke vepruar sipas dispozitave ligjore në fuqi.
4. Në grup shqyrtohen dhe bëhen propozime për dokumentacionin themelor mësimor, siç janë programet e lëndëve, (leksione, seminare), programet e praktikave mësimore, programet e praktikave profesionale, literatura e detyruar, literatura e sugjeruar për konsultim, etj.
5. Grupi mësimor propozon temat dhe udhëheqësit e diplomave dhe i paraqet ato për miratim në mbledhjen e njësisë bazë. Pas miratimit ai ndjek zbatimin e tyre.
6. Mbi bazë grupi hartohen pasqyrat e parashikimit dhe të realizimit të ngarkesave mësimore si dhe planeve kalendarë semestralë (syllabuset) dhe ndiqet në vazhdimësi ecuria dhe realizimi i tyre. Parashikimi i grupit i paraqitet për shqyrtim e miratim drejtuesit të njësisë bazë.
7. Për secilën lëndë që mbulon grupi caktohet pedagogu titullar i saj, i cili merr përsipër të hartojë programin e saj mësimor dhe më pas e paraqet atë tek drejtuesi i njësisë bazë për diskutim dhe miratim në departament.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

8. Sipas nevojave që nxjerr koha, grupi i propozon drejtuesit të njësisë bazë dhe ndryshimet përkatëse në mbulimin e lëndëve me pedagogë titullarë.
9. Grupi harton programet e kualifikimit të ciklit të tretë për disiplinat që mbulon, më tej ia dërgon ato për miratim departamentit.
1. Personeli akademik i një grupi mësimor mund të plotësojë ngarkesën vjetore të punës me veprimtari kërkimore në grupin e përhershëm/e përkohshëm me karakter kërkimor-shkencor ose anasjelltas, sipas akteve nënligjore aktuale dhe të pritshme.

B. Për funksionimin dhe veprimtarinë e grupit të përhershëm/ të përkohshëm me karakter kërkimor-shkencor.

2. Grupi i përhershëm/i përkohshëm me karakter kërkimor-shkencor kryen "Veprimtari kërkimore" (VK), që nënkupton kërkimin logjik dhe sistematik të informacioneve të reja dhe të dobishme me synim gjetjen e përgjigjeve për pyetjet që lindin dhe të zgjidhjeve të problemeve në fusha të ndryshme të shkencës nëpërmjet analizave objektive dhe përdorimit të metodologjisë së duhur shkencore. Kjo veprimtari finalizohet me punë origjinale teorike ose eksperimentale të cilat ofrojnë përfundimin e njohurive të reja, pa pasur pikësynim të drejtpërdrejtë ndonjë zbatim ose përdorim praktik të saj.
3. Grupi i përhershëm/i përkohshëm me karakter kërkimor-shkencor kryen veprimtari dhe ofron produkt konform termit "*Kërkim shkencor bazë*" (KSHB), që nënkupton punën krijuese të ndërmarrë dhe të realizuar në mënyrë sistematike, e cila ka për qëllim shtimin dhe zhvillimin e njohurive shkencore në fushë të caktuar, të gjerë apo specifike.
4. Grupi i përhershëm/i përkohshëm me karakter kërkimor-shkencor zhvillon veprimtari në kontekstin e termit "*Kërkim shkencor i zbatuar*" (KSHZ) që finalizohet me punë origjinale kërkimore e ndërmarrë për të zgjidhur problemet specifike të përdorimit praktik. KSHZ dallohet nga KSHB, sepse nuk synon përfundimin apo prodhimin e njohurive të reja të përgjithshme.
5. Grupi i përhershëm/i përkohshëm me karakter kërkimor-shkencor kryen veprimtari "*Zhvillimi eksperimental*" (ZHE), e cila nënkupton punë sistematike e mbështetur mbi njohuritë ekzistuese të fituara nga *kërkimi bazë* apo *i zbatuar*



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

dhe mbi të dhënat shkencore, e orientuar drejt prodhimit të produkteve apo të pajisjeve të reja dhe që ka për qëllim njohjen, studimin, zhvillimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tyre.

6. Grupi i përhershëm/i përkohshëm me karakter kërkimor-shkencor, në funksion dhe në emër të departamentit, mund të kryejë edhe aktivitet e shërbime për të tretët duke vepruar sipas dispozitave ligjore në fuqi. Ai mund të menaxhojë fonde nga fondi bazë i kërkimit-shkencor të departamentit, gjithmonë në funksion dhe për llogari të departamentit.
7. Grupi i përhershëm/i përkohshëm me karakter kërkimor-shkencor kontribuon në departament për hartimin e kurrikulave të ciklit të dytë MSH e sidomos të ciklit të tretë të studimeve (Doktoratë) si dhe ofron mësimdhënie në këto programe studimi.

C. Për rolin, funksionin dhe detyrat e përgjegjës të grupit mësimor apo grupit të përhershëm/të përkohshëm me karakter kërkimor-shkencor në departamente.

1. Çdo grup mësimor apo grup i përhershëm/i përkohshëm me karakter kërkimor-shkencor do të ketë përgjegjësin e tij të zgjedhur (nga kategoria e personelit akademik "Profesor" dhe "Doktor"), sipas kritereve dhe procedurave të propozuara nga vetë departamentet dhe fakultetet respektive, kritere dhe procedura të cilat do të pasqyrohen në Statutin dhe Rregulloren e re të UV- së.
2. Përgjegjësi i grupit mësimor apo i grupit të përhershëm/ të përkohshëm me karakter kërkimor-shkencor do të trajtohet me pagë shtesë, (110500 lekë Prof. dhe 9700 lekë Doktor) në bazë të VKM nr. 507, datë, 01. 08. 2012, "*Për disa ndryshime në VKM-në nr. 748, datë 11. 06. 2009, Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik, të institucioneve publike të arsimit të lartë, të ndryshuar*".
3. **Përgjegjësi i grupit mësimor** e kërkimor apo i grupit të përhershëm/ të përkohshëm me karakter kërkimor-shkencor, veç detyrave të tjera të përcaktuara nga ligji dhe aktet normative në fuqi, ka edhe këto detyra për ushtrimin e funksioneve të tij:
 - a) Organizon hartimin e kurrikulave të disiplinave që mbulon grupi dhe i paraqet në departament për diskutim.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

- b) Mbikëqyr respektimin e programeve të mësimdhënies në kohën e në mënyrën e caktuar, kërkimeve shkencore dhe veprimtarive të tjera.
- c) Ndjek aktivitetin shkencor të anëtarëve të grupit dhe për problemet që lindin informon autoritetet drejtuese.
- d) Raporton tek përgjegjësi i departamentit për realizimin e programit mësimor në përfundim të çdo semestri duke pasqyruar dhe mendimet e grupit mësimor.
- e) Organizon analizën vjetore të punës dhe depoziton në departament dokumentacionin e aktivitetit shkencor të secilit anëtar
- f) Mbikëqyr realizimin e ngarkesës mësimore të grupit.
- g) Evidenton, verifikon dhe kur është rasti i propozon përgjegjësit të departamentit për shkeljet e disiplinës në punë nga punonjësit e grupit.
- h) Mbikëqyr respektimin e disiplinës në punë, merr masat përkatëse për rivendosjen e rregullit në rast shkeljesh e të metash. Në rastet e rënda ose kur e çmon njofton përgjegjësin e departamentit dhe dekanin me rekomandimet përkatëse organizative e disiplinore.
- i) Mbi bazën e detyrave të mësipërme harton dokumentin e performancës dhe disiplinës pedagogjike, akademike dhe shkencore të anëtarëve të grupit që drejton dhe ia paraqet atë me shkrim, për miratim, përgjegjësit të departamentit, apo dekanit dhe rektorit nëse këta të fundit e kërkojnë një gjë të tillë.

C. Për procedurat dhe standardet e shpërndarjes së ngarkesave mësimore vjetore në auditor.

- 1. Një grup mësimor/kërkimor-shkencor përbëhet nga personel akademik me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar me kohë të plotë dhe ai ndihmësakademik sipas organikës përkatëse të fakultetit, të cilët i bashkon fusha e ngushtë e studimit dhe në raste të tjera edhe fusha e gjerë e studimit. Pra, grupi përfshin personel akademik me fusha të njëjta ose të përafërta studimi apo që ofrojnë mësimdhënie të disiplinave me objekte studimi të përafërta.
- 2. Fusha e studimit të personelit akademik me/pa grada dhe me/pa tituj dëshmohehet përmes tipologjisë së:
 - a) artikujve para MSH,
 - b) studimit të mikrotezës për MSH,
 - c) artikujve paradoktoralë,
 - ç) studimit doktoral,



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

- d) artikujve postdoktoralë,
dh) ligjëratave përfundimtare në kërkim të titullit “Profesor i asociuar” dhe “Profesor”.
3. Mbi bazën e fushës së studimit kryhet edhe ndarja e ngarkesës mësimore në auditor (disiplinat, lëndët, modulet etj.). Një personel akademik që e dëshmon qartazi fushën e studimit sipas tipologjive të përmendura më sipër dhe që disiplinat të cilat zhvillon në fushën e tij, ia plotësojnë ngarkesën mësimore vjetore në auditor, (sipas Udhëzimit nr. 20 të MASH), nuk mund të zhvillojë mësim në disiplina të fushave të tjera të studimit.
 4. Vetëm **a)** për qëllime të plotësimit të numrit minimal 3 (tre) të grupeve mësimore, **b)** të nevojave praktike të mësimdhënies dhe **c)** plotësimit të ngarkesës mësimore të ndonjë pedagogu, (për shkak të mungesës në departament të personelit të kualifikuar në një fushë të caktuar studimi), një pedagog mund të zhvillojë disiplina që nuk janë në fushën e tij të studimit dhe mund të jetë anëtar i atij grupi mësimor që i përket disiplina.
 5. Përgjegjësit e departamenteve, përpara se të paraqesin variantin e tyre të shpërndarjes së ngarkesës mësimore vjetore në auditor, në departament, kryejnë konsulta paraprake të detyrueshme me dekanët dhe personelin akademik me titullin “Prof. dr.” të cilët janë titullarë të lëndëve dhe disiplinave si dhe autoritete me përvojë në këtë fushë.
 6. Ngarkesa mësimore në auditor është pjesë e kohës vjetore të punës dhe procedurat për finalizimin e tyre respekton rigorozisht të gjitha anekset e Udhëzimit nr. 20 të MASH-it, përfshirë dhe Marrëveshjen Tip, bashkëlidhur këtij udhëzimi.
 7. Mosrespektimi i Udhëzimit nr. 20 të MASH-it dhe kërkesave të këtij Vendimi nga ana e përgjegjësve apo anëtarëve të njësive bazë, përbën shkak ligjor për marrjen e masave administrative.
 8. Kërkesat e këtij vendimi të reflektohen në Rregulloren mësimore të UV-së në momentin e miratimit të saj.
 9. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi: Rektori, Kancelari, zv/Rektori, Dekanët, Përgjegjësit e departamenteve, Përgjegjësit e grupeve mësimore, Personeli akademik, Drejtoria e Financës dhe Sektori i burimeve njerëzore.



**REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK**

10. Vendimi protokollohet dhe bëhen njoftimet përkatëse.

11. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Roland ZISI**

Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.